

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SARANDË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Sarandë me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 188, datë 31.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 941/19, datë 31.12.2012, dërguar z. **Stefan ÇIPA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa, nga Bashkia Sarandë instalimin dhe përdorimin e një prej programeve elektronike për financën, me qëllim regjistrimin e të gjitha veprimeve të kontabilitetit.

Menjëherë

2. Nga Drejtoria e Ekonomike në bashki të kryhen sistemimet e nevojshmen në kontabilitet konformë rregullave të caktuara për llogaritë inventariale (aktive të qëndrueshme dhe qarkulluese), në përgatitjen e bilancit të vitit 2012.

Brenda muajit Mars 2013

3. Nga Drejtoria Ekonomike të kryhet sistemimi i ndryshimit të gjendjeve të inventarit, të rezultuar gjatë auditimit, duke zbritur vlerën prej 2,469,892 lekë, në mbylljen e bilancit të vitit 2012.

Brenda muajit Mars 2013

4. Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa të sistemohen në kontabilitet sipas rregullave, tepricat e llogarive të debi-kredive, duke i shoqëruar ato me analizat për secilën llogari.

Brenda muajit Mars 2013

5. Nga Bashkia Sarandë të merren masa që buxheti i bashkisë për vitet e ardhshme, të miratohet në Këshillin Bashkiak, brenda vitit paraardhës.

Vazhdimisht

6. Nga Drejtoria Ekonomike, të merren masa për riorganizimin e zyrës së arkës, e cila aktualisht u shërben dy institucioneve me bilance më vete, duke bërë veçimin e përdorimit nga Zyra Ekonomike e Arsimit.

Menjëherë

7. Nga Bashkia Sarandë të merren masa, për të ardhmen e krijuara nëpërmjet arkës të derdhen në buxhet sipas klasifikimeve buxhetore.

Vazhdimisht

8. Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për të bërë kontabilizimin në llogaritë përkatëse të ndërtesës së bashkisë, shkollave, çerdheve, kopshteve, etj., të cilat janë në administrim të bashkisë duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi për vlerësimin e objekteve.

Menjëherë

9. Nga Drejtoria Ekonomike të programohen në buxhet të bashkisë, në zë të veçantë të ardhurat e krijuara nga vitet e mëparshme nga aplikimi i taksës prej 1 % të investimit për lejet e ndërtimit në vlerën 110,595 mijë lekë dhe të përdoren në vijimësi për pagesën e projekteve të infrastrukturës.

Brenda muajit Qershor 2013

10. Nga Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të merren masa, për nëpunësit që kanë fituar konfliktet gjyqësore dhe që kanë vendim gjykate të formës së prerë, për t'u dëmshpërblyer sipas legjislacionit në fuqi për këto raste.

Vazhdimisht

11. Të merren masa nga Bashkia Sarandë duke bashkëpunuar me ZRPP-Sarandë, për objektin ish Agjencia e Sharrimit të Lendeve Drusore, e kaluar në pronësi të Bashkisë me VKM nr.8, datë 13.01. 2000 "Për një shtesë në VKM nr.378, datë 12.08.1999" për të bërë të mundur regjistrimin në ZVRPP Sarandë dhe administrimin e dokumentacionit të objektit nga Bashkia Sarandë.

Brenda datës 31.03.2013

12. Nga Bashkia Sarandë të merren masa së bashku me Drejtorinë e Taksa Tarifave bazuar në të dhënat që disponon Bashkia, dhe të realizimeve të mëparshme, duke i programuar ato analitikisht duke bërë dhe vlerësimin me grup pune në terren për të rishikuar e miratuar një plan sa më real.

Vazhdimisht

13. Të merren masa nga Drejtoria e Taksave, që në të gjitha rastet në dosjet e biznesit të vogël të administrohet, dokumentacionin i kërkuar ligjor si dhe librat e blerjeve dhe të shitjeve për vitin 2010 dhe vitin 2011 e në vazhdim, kërkesa këto të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshime dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008.

Brenda muajit Prill 2013

14. Të merren masa nga Drejtoria e Tatim Taksave që të evidentohen, subjektet që kanë transferuar aktivitetin, subjektet që mbahen në pasiv dhe nuk janë identifikuar nga kontrollet në terren, subjektet me dublim të numrit të NUIS-it, të dhënat e pronësisë mbi ndërtesat, të dhënat për pronat me qira apo në përdorim, të dhënat për hipotekimin e pronave me vendim gjykate, me qëllim rritjen e të ardhurave nga përdorimi i këtyre pronave sipas tarifave të vendosura nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

15. Të merren masa duke ngritur grup pune për të saktësuar sipërfaqet e hapësirave publike, të konstatuara e reklamuar nga Drejtoria e Urbanistikës dhe të njoftohet Drejtoria e Tatim

Taksave, për të llogaritur e evidentuar duke marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të llogaritura.

Brenda muajit Prill 2013

16. Të ngrihet grup pune dhe të bëhen plotësimet e nevojshme në Rregulloren e Bashkisë, në të cilën të përcaktohen detyrat funksionale për çdo drejtori dhe për Drejtorinë e Urbanistikës në veçanti, në drejtim të orientimit të mëtejshëm të saj nga ana ligjore, koordinative dhe bashkërenduese ndërmjet sektorëve që funksionojnë brenda kësaj drejtorie, duke evidentuar përgjegjësinë e Drejtorisë së Urbanistikës për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues.

Brenda muajit Shkurt 2013

17. Nga Bashkia Sarandë si Autoriteti Vendor i Planifikimit të merren masa, për vlerësimin dhe rishikimin e strukturës dhe formatit të Planit të Përgjithshëm Vendor, në përputhje me ligjin e ri, pasi përfundimi i rishikimit dhe miratimit të PPV-së është detyrim ligjor dhe i hap rrugën zhvillimit të territorit në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim që shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit për planifikimin e territorit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Brenda muajit Mars 2013

18. Të ngrihet një grup pune për verifikimin e dosjeve të lejeve të shesheve, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të shfrytëzimit me qëllim evidentimin e mangësive dhe plotësimin e tyre me dokumentacionin e kërkuar, përcaktimin e kondicioneve urbanistike, studimin e gjendjes ekzistuese. Kjo të përdoret për orientimin e grupit të punës në procesin e hartimit të planit të përgjithshëm rregullues si dhe të arkivohen dosjet sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

Brenda muajit Qershor 2013

19. Nga Bashkia Sarandë si Autoriteti Vendor i Planifikimit të merren masa për hartimin e miratimin e instrumenteve të planifikimit në nivel vendor dhe ndër vendor, si PZHNJV, Plani i Përgjithshëm Vendor për Planifikimin e Territorit dhe Rregullorja e Planifikimit për PPV, si detyrim ligjor për të gjitha njësitë vendore.

Brenda muajit Shkurt 2013

20. Nga Bashkia Sarandë si Autoriteti Vendor i Planifikimit të merren masa, që lejet e ndërtimit të miratuara para hyrjes në fuqi të ligjit të planifikimit dhe lejet e ndërtimit që janë në zbatim, të ndiqet zbatimi i tyre, në përputhje me kushtet e lejes së dhënë dhe me kërkesat ligjore që kanë tagër për të ndikuar në periudhën aktuale.

Vazhdimisht

21. Nga Bashkia Sarandë si Autoriteti Vendor i Planifikimit të merren masa, që ndërtimet e përfunduara para hyrjes në fuqi, me efekte të plota të ligjit për planifikimin e territorit, lejen e përdorimit (leja e shfrytëzimit) ta marrin në përputhje me kushtet e zbatimit të lejes së ndërtimit të miratuar.

Vazhdimisht

22. Të plotësohen, sipas ligjit, të gjitha dosjet e lejeve të shfrytëzimit me aktet e kontrollit për përfundimin e sistemimit të jashtëm në sheshin e ndërtimit sipas projektit, me situacionet përfundimtare të punimeve, kopjet e licensave të kolaudim, mbikëqyrje dhe projektim, si dhe me gjithë dokumentacionin tjetër, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Më pas, në

përputhje me vleftën e situacioneve përfundimtare të bëhet korrektimi i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja. Sipas rezultateve të evidentura, të bëhet kontabilizimi si debitorë dhe të arkëtohen vleftat përkatëse.

Brenda muajit Mars 2013

23. Të plotësohen dosjet me Leje Shfrytëzimi nr. 1371, datë 26.12.2006 Banesë 5 katëshe me subjekt zbatues "██████" sh.p.k. dhe nr. 475, datë 09.05.2006, Banesë 2 kate, zona: Lagja nr. 3 Sarandë, sipas ligjit, me dokumentacionin e nevojshëm leje sheshi, leje ndërtimi dhe aktkollaudimi, në të kundërt ndërtimet e kryera të konsiderohen të paligjshme dhe të ndiqen procedurat përkatëse në kushtet e reja.

Brenda muajit Mars 2013

24. Për te gjitha trojet e shitura nga Bashkia Sarandë, prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7980, datë 29.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" e deri më sot, si dhe për të gjithë aktvlerësimet e bëra nga kjo Bashki për trojet që disponohen nga personat për të kryer ndërtime, të bëhen rillogaritjet e çmimit sipas VKM nr. 1620, datë 26.11.2008.

Pas kësaj të bëhet regjistrimi si debitorë i gjithë personave përfitues të trojeve, për diferencën e vlerës ndërmjet çmimit aktual dhe çmimit të shitjes apo vlerësimin, duke zbatuar të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e diferencës së vleftës dhe përfitimet të kontabilizohen në llogaritë e kompensimit të ish-pronarëve.

Brenda muajit Dhjetor 2013

25. Të merren masa nga Bashkia Sarandë që për kontratën e lidhur me z. Lirim Maca, për objektin "██████", me sipërfaqe të përgjithshme 1028 m² dhe sipërfaqe nën objekt 350 m², të bëhet rinegociimi me qiramarrësin, për të ulur tarifën e qirasë në 73,000 lekë në vit, vlerë e përcaktuar sipas ankandit të zhvilluar. Në të kundërt për diferencën prej 25,188 lekë në vit, të nxirret përgjegjësia për personat përkatës.

Brenda muajit Janar 2013

26. Të merren masa, nga Bashkia Sarandë, që të bëhet në mënyrë grafike azhurnimi i rrjetit inxhinierik për shkarkimin e ujërave të zeza dhe të bardha të qytetit, në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. Sarandë. Në rrjetin e azhurnuar të pasqyrohen lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të dhëna, për periudhën 2006-2011 e në vazhdim. Të merren masa për të evidentuar dhe pasqyruar grafikisht lidhjet e shkarkimeve të ujërave të zeza dhe të bardha, me rrjetin inxhinierik të qytetit, të azhurnuar si me ndërtimet aktuale e në vazhdim.

Brenda muajit Mars 2013

27. Të merren masa, nga Bashkia Sarandë, të ngrihet grup pune me specialistë të fushës, në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", me ndryshime, Kreu i VIII germa "b" të vlerësohen përgjegjësitë në zbatimin e kontratës për Sipërmarrësin "██████", në lidhje me diferencat në vlerë 2,239,446 lekë, konstatuar nga auditimi, për objektin "Rikonstrukcion i Rrugës së Vilës" dhe për diferencat që do të rezultojnë, të ndiqen hapat ligjore për arkëtimin e tyre.

Brenda muajit Mars 2013

28. Ngarkohet Bashkia Sarandë, që për ish nëpunësit e larguar nga puna të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, në rastin kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre, ka ndikuar në funksionin administrativ të Bashkisë, si dhe të nxjerrë klasifikimin e

përgjegjësive dhe pozitat e tyre në referim të ligjit për kundravajtjet administrative dhe përgjegjësitet jashtë kontraktore, duke përcaktuar dhe masat disiplinore përkatëse.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Bashkia Sarandë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit me vlerën **70,320,778 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

I. Në fushën e Urbanistikës për mos pagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën totale 55,437,989 lekë:

1. Subjekti “**██████**” në shumën prej **15,387,169 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 3/21, datë 13.09.2010 dhe 4/24, datë 17.12.2008.
2. Subjekti “**██████**” në shumën prej **13,376,142 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 4/29, datë 26.08.2010 dhe nr. 4/30, datë 26.08.2010.
3. Subjekti “**██████**” në shumën prej **11,694,703 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 3/62, datë 10.06.2009.
4. Subjekti “**██████**” në shumën prej **5,737,215 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 2/17 datë 26.08.2010, 2/22 datë 13.09.2010 dhe 2/18 datë 26.08.2010.
5. Subjekti “**██████**” në shumën prej **3,309,972 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 3, datë 10.09.2003.
6. Subjekti “**██████**” në shumën prej **2,520,538 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 3/25, datë 13.09.2010.
7. Subjekti “**██████**” në shumën prej **1,794,393 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 3/34, datë 10.06.2009.
8. Subjekti “**██████**” në shumën prej **1,542,245 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 3/25, datë 13.09.2010.
9. Subjekti “**██████**” në shumën prej **75,612 lekë** për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit nr. 2/22, datë 30.01.2009.

II. Në fushën e prokurimeve publike (prokurime plus zbatim punimesh) totali 12,743,299 lekë:

A. Në fushën e prokurimeve publike, në vlerën prej 6,407,467 lekë, në 8 tendera:

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga **██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 1,956,640 lekë**, pasi në tenderin elektronik me objekt: “Pastrimi i qytetit të Bashkisë Sarandë”, kanë s’kualifikuar operatorin ekonomik “Shpresa”, në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.
2. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga **██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 1,142,139 lekë**, pasi në tenderin elektronik me objekt: “Ndërtim i Rrugës nr. 1, Gjashtë, Loti II”, viti 2011, kanë s’kualifikuar operatorin ekonomik konkurrues “**██████**”, në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.
3. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga **██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 984,222 lekë**, pasi në tenderin, elektronik me objekt: “Rikonstruksion KUB, KUZ i Rrugës Turizmit-Peshkimi i Vjetër, Sarandë”, kanë

s'kualifikuar operatorin ekonomik -BOE "██████████", në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.

4. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga ██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 889,392 lekë, pasi në tenderin elektronik me objekt: "Rikonstruksion i Stadiumit të Futbollit, Sarandë", kanë s'kualifikuar operatorin ekonomik konkurrues "██████████", në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.

5. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga ██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 563,312 lekë, pasi në tenderin elektronik, me objekt: "Punime në ambientet e brendshme në stadiumin e futbollit, Sarandë (vazhdim)", kanë s'kualifikuar operatorin ekonomik "██████████", në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.

6. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga ██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 376,112 lekë, pasi në tenderin elektronik, me objekt: "Ndërtim, asfaltim Rruga H.Freskia-Xhamia-Manastiri i 40 Shenjtorëve", kanë s'kualifikuar operatorin ekonomik "██████████", në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.

7. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga ██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 254,760 lekë, në tenderin elektronik me objekt: "Sistemim e asfaltim segmente rrugore në zonën e sipërme të qytetit (L. Dardhës mbi Spital), Sarandë", kanë s'kualifikuar operatorin ekonomik "██████████", në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.

8. Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga ██████ Kryetar; ██████ dhe ██████ anëtarë dhe ██████ titullari i autoritetit kontraktor, vlerën 240,890 lekë, në tenderin me objekt: "Sistemim asfaltim i bllokut të banimit pas Hotel Butrintit", kanë s'kualifikuar operatorin ekonomik -BOE "██████████", në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi si dhe në kundërshtim me kërkesat e veçanta të kualifikimit, të miratuara nga autoriteti kontraktor.

B. Diferencat për punime të pakryera dhe diferenca zëra punimesh në 10 objekte, në vlerën 6,335,832 lekë:

1. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 1,694,140 lekë, për objektin "Ndërtim i linjës së ujës-jellësit";

2. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 916,014 lekë, për objektin "Rikonstruksion i Rrugës V. Pandi p.k 7 – pk 20";

3. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 721,450 lekë, për objektin "Sistemime publike, lagjja 3, blloku 3, loti II";

4. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 633,902 lekë, për objektin "Rikonstruksion i stadiumit";

5. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 615,786 lekë, për objektin "Rikonstruksion i Rrugës Nr. 3 Gjashtë";

6. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 596,100 lekë, për objektin "Riveshje, SA Rrugë të qytetit";

7. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 578,240 lekë, për objektin "Rikonstruksion i rrugës V. Pandi pk 7 – pk 20";

8. Sipërmarrësi "██████████", për vlerën 277,320 lekë; për objektin "Ndërtim KUZ dhe KUB Turizëm – Peshkimi i vjetër";

9. Sipërmarrësi “██████████”, për vlerën 242,880 lekë, për objektin “Rikonstruksion i rrugës V. Pandi pk 1-7”;

10. Sipërmarrësi “██████████”, për vlerën 60,000 lekë, për objektin “Punime, ambiente të brendshme në stadium”.

III. Në fushën e Tatim Taksave, Detyrimi prej 1,919,676 lekë në 10 raste si më poshtë:

1. Hotel “██████████” me nr. NIPT K64105807S, detyrimi i pa paguar në shumën 418,798 lekë.
2. Hotel “██████████” me nr. NIPT L84313804M, detyrimi i pa paguar në shumën 334,820 lekë.
3. Hotel “██████████” me nr. NIPT K84007801L, detyrimi i pa paguar në shumën 334,670 lekë.
4. Hotel “██████████” me nr. NIPT K84205802G, detyrimi i pa paguar në shumën 187,520 lekë.
5. Hotel “██████████” me detyrimi i pa paguar në shumën 143,320 lekë.
6. Hotel “██████████” me detyrimi i pa paguar në shumën 137,420 lekë.
7. Hotel “██████████” me detyrim i pa paguar në shumën 127,120 lekë.
8. Hotel “██████████” me nr. NIPT K94501802S, detyrimi i pa paguar në shumën 115,920 lekë.
9. Hotel “██████████” me nr. NIPT K94420803E, detyrimi i pa paguar në shumën 102,400 lekë.
10. Hotel “██████████” me nr. NIPT L14508801Q, detyrimi i pa paguar në shumën 17,688 lekë.

IV. Në fushën e dhënieve me qira të pasurive të ndërmarrjeve dhe institucioneve me sipërfaqe trualli nën objekt, në vlerën prej 219,814 lekë, për 5 subjekte, për detyrime të pa arkëtuara deri më datë 31.12.2011.

Deri në 31.03.2013

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C/I Në zbatim të nenit 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” germat (b, c, d), të ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu X, ti kërkohet APP-së, që t’i rekomandojë autoritetit kontraktor për vendosjen e masës së gjobës prej 100,000 lekë për secilin anëtar të HDT, e konkretisht:

1. ██████████, Jurist në 17 tendera,
2. ██████████, anëtare në 10 tendera,
3. ██████████, anëtar në 10 tendera,
4. ██████████, anëtar në 10 tendera,
5. ██████████, anëtare në 7 tendera,

-për mosrespektim të rregullave të prokurimit publik, të zhvilluara në periudhën 01.01.2008-31.12.2011, e konkretisht:

a-në mos hartimin e plotë të dokumenteve të tenderave, kërkesave për kualifikim dhe kriterëve të vlerësimit si dhe mos argumentimin me hollësi në vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratave, ku përmendim disa fenomene më kryesore:

-është kërkuar dokumenti i sigurimit të ofertës sipas shtojcës nr. 3, me cilësimin “nëse është e zbatueshme”. Me këtë cilësim nuk bëhet konkurrimi me bazë të njëjtë krahasimi;

-është miratuar për të paraqitur një dokument nga banka me cilësimin “...deri në masën 10%”. Pra është lënë evazive dhe nuk konkurrohet me bazë të njëjtë krahasimi;

-për licencat profesionale të shoqërive janë kërkuar kategoritë e punimeve përkatëse, por nuk janë cilësuar klasifikimet e germave përkatëse (klasifikimin e shoqërive ndërtimore me niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi). Është, kërkuar paraqitja e licencave pa cilësuar se nga cili institucion duhet marrë. Pra, nuk duhet lënë klauzola “institucioni kompetent”. Gjithashtu ka

raste të mos cilësoheshin se me cilat licenca duhet punuar (pasi në atë kohë ka pasur në qarkullim licenca me kategori të vjetra dhe të reja) apo konvertimet përkatëse.

-është kërkuar inxhinier zbatimi mekanik, apo ndërtimi, etj. me cilësim *“me përvojë jo më pak se 5 vjet në zbatim”*, por nuk është kërkuar dokumenti provë vërtetues, dokument i cili është vetëm librezë e punës, e jo cv-të, licencat apo kontratat e lidhura;

-janë kërkuar makineri e asete me cilësim: *“10 ton mjete, ose 20 ton mjete”* pa cilësuar numrin e tyre, sepse 10 ton apo 20 ton mjete janë terma të pa kuptueshme, ku në shtojcat përkatëse nr. 18 e të ndryshuar më vonë në nr. 8 *“deklarata e disponimit të makinerive dhe aseteve”* nuk kanë ndonjë të dhënë për tu plotësuar tonazhet, por kërkohet vetëm numri në copë. Pra, është kërkesë kualifikuese me shumë interpretime, deri e pa zbatueshme.

b-kërkesat e veçanta të kualifikimit në shumicën e tenderave të audituar janë vendosur në kriteret specifike të kualifikimit, ku bëhen shpjegime në DST nga APP. Pra, nuk është kaluar tek dokumenti i miratuar me DST, shtojca nr. 9, dokument i cili sipas DST është i detyruar të plotësohet nga autoriteti kontraktor. Rastet konkrete janë cilësuar më poshtë tek mangësitë e veçanta.

c-janë hartuar procesverbalet e vlerësimit të operatorëve ekonomik konkurrues pa përgjegjësi;

d-është konstatuar mos zbatim i plotë të Kreut II, neni 12 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, me ndryshimet, si dhe Kreut V, pika 1, germa *“c”* të VKM nr. 1, datë 10.01.2007;

e-është konstatuar mos kthimi i përgjigjeve për të liruar sigurimet e ofertave operatorëve ekonomik pjesëmarrës në konkurrim, të cilët nuk janë shpallur fitues;

C/II. Ti propozohet Kryeinspektorit të Inspektoratit të Ndërtimit dhe Urbanistikës pranë Bashkisë Sarandë, mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* me ndryshime, neni 15, për shkelje të neni 7, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”*, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, të vendos gjobë personat e mëposhtëm:

1. **Z. [REDAKTUAR]**, gjobë në masën **100,000 lekë**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin *“Rikonstruksioni i Rrugës së Vilës”* ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerë 2.239.446 lekë, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuar.

2. **Z. [REDAKTUAR]**, gjobë në masën **100.000 lekë** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin *“Rikonstruksioni i Rrugës Vangjel Pandi”* ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerë 821.120 lekë, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuar

3. **Z. [REDAKTUAR]**, gjobë në masën **100,000 lekë** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit si përfaqësues i shoqërisë *“[REDAKTUAR]”*, në objektin *“Rikonstruksioni i Rrugës së Peshkimit”* ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerë 716.934 lekë, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuar

4. **Z. [REDAKTUAR]**, gjobë në masën **100,000 lekë** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, në objektin *“Ndërtimi i Rrjetit inxhinierik KUB dhe KUZ në rrugën Turizëm – Peshkimi i vjetër”*, ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerë 277.230 lekë, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuar

5. **Z. [REDAKTUAR]**, gjobë në masën **100.000 lekë** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, në objektin *“Rikonstruksioni i Rrugës Nr. 3 Gjashtë”*, ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerë 615.786 lekë, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuar

6. **Z. [REDAKTUAR]**, gjobë në masën **100.000 lekë** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, në objektin *“Sistemime publike, Lagja Nr. 3, Blloku Nr. 3, Loti II, Sarandë”*, ku është konstatuar

një dëm ekonomik në vlerë 721.450 lekë, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuar.

D. MASA DISIPLINORE

1. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, ligjit nr. 7829, datë 01.6.1994 “Për Noterinë”, neni 14, sipas të cilit Ministria e Drejtësisë ushtron kontrollin mbi veprimtarinë ligjore të noterëve, nenet 6, 7 dhe 8, për përmirësimin e gjendjes, i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve **marrjen e masave disiplinore për noterët:**

1. z. [REDAKTUAR], me detyrë noter në lidhjen e 11 kontratave,
2. z. [REDAKTUAR], me detyrë noter në lidhjen e 2 kontratave,
3. z. [REDAKTUAR], me detyrë noter në lidhjen e 1 kontrate,
4. z. [REDAKTUAR], me detyrë noter në lidhjen e 4 kontratave,
5. z. [REDAKTUAR], me detyrë noter në lidhjen e 1 kontrate .

Për përpilimin dhe noterizimin e kontratave të shitblerjes së trojeve “*pronë publike*” me subjekte private, ku si palë shitëse është Bashkia Sarandë, e cila nuk ka titull ligjor si pronare e trojeve të shitura, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 38, “Regjistrimi i fitimit të pronësisë me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, “*në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë*”, element ky i domosdoshëm në hartimin dhe lidhjen e kontratave të shitblerjes së trojeve, të cilat janë lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3, “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve.....”, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën” nenin 55, “Shitja e truallit pronë shtetërore ose publike bëhet në përputhje me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”. Në rastet e ndërtimeve në prona publike, në çastin e marrjes së lejes së ndërtimit, personi fizik e juridik paguan 50 për qind të vlerës së truallit dhe, kur përfundon karabinaja e katit të parë, paguhet edhe pjesa tjetër e kësaj vlere”, me ligjin nr. 7829, datë 01.6.1994 “Për noterinë”, nenin 54 “Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim ajo i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të lëshuara nga organi kompetent dhe, kur sendi nuk figuron i regjistruar, një vendim gjyqësor detyrimi për vërtetim pronësie. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë”

(të trajtuara në faqet 168-171 të pikës nr. X të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 13, germa (i), ti kërkohet APP-së, që ti propozojë drejtuesit të autoritetit kontraktor- Bashkisë Sarandë, për punonjësin që është aktualisht në marrëdhënie pune, [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit, e në cilësinë e anëtarit të KVO-së pjesëmarrës në 17 tendera, masën disiplinore “*Largimi nga shërbimi civil*”, mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nën-punësit Civil”, i ndryshuar, Kreu VIII “Masat disiplinore”, pika 3, germa “d”, për shkelje të rregullave të prokurimit publik, të zhvilluara në periudhën 01.01.2008 deri 31.12.2011, e konkretisht:

-mos zbatim të plotë të nenit nr. 1, pika 2, dhe nenit 12 të LPP-së, pasi nuk ka rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; nuk ka siguruar mirë përdorimin e fondeve

publike; nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, e konkretisht të procedurave të mëposhtme:

i) duhej të ishin anuluar dhe përsëritur nga e para 9 tendera, sepse nuk kanë elementin e dytë të konkurrimit (operatorin konkurrues) ose nuk kanë plotësuar që të gjithë 100% kërkesat për kualifikim, me vlerë totale fondi limit me tvsh-në prej 121,060 mijë lekë ose në vlerë totale të kontratave të lidhura me tvsh-në prej 103,365 mijë lekë, në këto tendera:

-“Ndërtim i Rrugës nr. 1, Gjashtë, Loti II”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh-në 15,245,004 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 11,145,989 lekë;

-“Rikonstrukcion i Stadiumit të Futbollit, Sarandë”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh-në 10 milion lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 7,809,138 lekë;

-“Sistemim asfaltim i bllokut të banimit pas Hotel Butrintit”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh-në 5,475,000 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 4,271,239 lekë;

-“Pastrimi i qytetit të Bashkisë Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh-në 26,357,860 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 26,177,673 lekë;

-“Sistemim e asfaltim segmente rrugore në zonën e sipërme të qytetit (L. Dardhës mbi Spital), Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh-në 5,187,000 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 3,820,740 lekë;

-“Asfalti i Rrugës Vilës”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh-në 42,120,310 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 34,285,473 lekë;

-“Ndërtim-asfaltim Rruga H.Freskia-Xhamia-Manastiri i 40 Shenjtorëve”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh-në 4,950,000 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 4,252,122 lekë;

-“Sistemime publike blloku nr. 1, lagja nr. 2 Sarandë”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh-në 5,625,000 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 5,560,500 lekë;

-“Rikonstrukcion i stadiumit dhe fushës së futbollit”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh-në 6,100,000 lekë, me vlerë kontrate me tvsh-në 6,041,568 lekë.

ii) ka shpallur fitues pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese për 13 tendera, me vlerë me fond limit me tvsh-në 151,300 mijë lekë;

iii) mos zbatim të procedurave të prokurimeve publike, duke u shoqëruar edhe me dëme ekonomike për buxhetin e bashkisë në vlerën prej **6,407,467 lekë**, për 8 tendera:

-“Ndërtim i Rrugës nr. 1, Gjashtë, Loti II”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **1,142,139 lekë**;

-“Rikonstrukcion i Stadiumit të Futbollit, Sarandë”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, me dëm ekonomik në vlerën **889,392 lekë**;

-“Sistemim asfaltim i bllokut të banimit pas Hotel Butrintit”, me procedurë “Kërkesë me propozim, me dëm ekonomik në vlerën **240,890 lekë**;

-“Pastrimi i qytetit të Bashkisë Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **1,956,640 lekë**;

-“Sistemim e asfaltim segmente rrugore në zonën e sipërme të qytetit (L.Dardhës mbi Spital), Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, **254,760 lekë**;

-“Ndërtim-asfaltim rruga H.Freskia-Xhamia-Manastiri i 40 Shenjtorëve”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **376,112 lekë**;

-“Punime në ambientet e brendshme në stadiumin e futbollit, Sarandë (vazhdim)”, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me dëm ekonomik në vlerën **563,312 lekë**;

-“Rikonstrukcion KUB, KUZ i Rrugës Turizmit-Peshkimi i Vjetër”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **984,222 lekë**.

iiii) nuk ka llogaritur dhe nuk ka lenë gjurmë llogaritje të ofertave ekonomike të paraqitura me vlerë anomalish të ulta si dhe nuk kanë praktika dokumentare për të tillë operator konkurrues konformë legjislacionit të prokurimeve publike, si: nenit 56 “Oferta anomalisht e ulët” të LPP-së, me ndryshimet dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, me ndryshimet, Kreu V, pika 4, germa (ë). Madje janë përdoruar standarde të ndryshme për të tillë operator ekonomik konkurrues si në rastet e s’kualifikimeve apo kualifikimeve të operatorëve ekonomik konkurrues dhe në rastet për fituesit e shpallur.

iiiii) ka përdorur kërkesa kualifikuese të pa miratuar më parë nga hartuesit e dokumenteve të tenderave për s’kualifikime të operatorëve ekonomik konkurrues, madje duke përdorur edhe standarde të ndryshme si për s’kualifikimet dhe kualifikimet e operatorëve ekonomik konkurrues dhe fituesit e shpallur.

iiiii) ka kryer s’kualifikime të operatorëve ekonomik konkurrues në një kohë që i plotësojnë kërkesat kualifikuese të miratuar nga HDT, madje edhe operator ekonomik që janë paraqitur me vlera më të vogla se fituesit e shpallur.

iiiii) për të gjithë tenderat e audituar, ka pranuar ofertat ekonomike, pa bërë përcaktimet për pjesët e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryente secili nga anëtarët, në rastet e konkurrimeve me bashkim operatorësh ekonomik. Madje edhe në kontratat e bashkëpunimit mes anëtarëve të grupit, në disa tendera janë pranuar pa vendosur përqindjet ose përcaktimet e zërave të punimeve, që do të realizohen nga çdo anëtar i grupit. Këto veprime bien ndesh me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, me ndryshimet, Kreu VII, pika 2, germat “a-b”.

D. KALLZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar “Për prokurimin publik” dhe ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

I. z. [REDAKTUAR], z. [REDAKTUAR], z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR], si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

1. për 17 tendera, nga këta me një dëm ekonomik në vlerë **6,407,467 lekë**, si më poshtë:

- për shkelle të barazisë në tender duke mos siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

- nuk kanë nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; nuk kanë nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

-për s’kualifikime të operatorëve ekonomik konkurrues duke përdorur kërkesa kualifikuese të pa miratuara më parë nga hartuesit e dokumenteve të tenderave, madje duke përdorur edhe standarde të ndryshme si për s’kualifikimet e kualifikimet e operatorëve ekonomik konkurrues dhe fituesit e shpallur.

-për s’kualifikime të operatorëve ekonomik konkurrues në një kohë që i plotësojnë kërkesat kualifikuese të miratuara nga Hartimin e dokumenteve të tenderave, madje edhe operator ekonomik që janë paraqitur me vlera më të vogla se fituesit e shpallur.

-për mos zbatim të kërkesave ligjore dhe mos llogaritje, mos lenie gjurmë të llogaritjeve si dhe mos plotësimin me praktika dokumentare për operator ekonomik konkurrues **në rastet e paraqitjeve me vlera anomalish të ulët**, konform legjislacionit të prokurimeve publike, si: nenit

56 “Oferta anomalisht e ulët” të LPP, me ndryshimet dhe V KM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 4, germa (ë). Gjithashtu janë përdorur standarde të ndryshme për të tillë operator ekonomik konkurrues, si në rastet e s’kualifikimeve apo kualifikimeve, si dhe në rastet për fituesit e shpallur;

-mos zbatim të plotë të nenit nr. 1, pika 2, dhe nenit 12 të LPP-së, pasi nuk kanë rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; nuk kanë siguruar mirë përdorimin e fondeve publike;

Konkretisht të procedurave dhe tenderave të mposhtëm:

A.1

mos zbatim të procedurave të prokurimeve publike, duke u shoqëruar edhe me dëme ekonomike për buxhetin e bashkisë në vlerën prej **6,407,467 lekë**, për 8 tendera:

-“Ndërtim i Rrugës nr. 1, Gjashtë, Loti II”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **1,142,139 lekë**,

-“Rikonstruksion i Stadiumit të Futbollit, Sarandë”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, me dëm ekonomik në vlerën **889,392 lekë**,

-“Sistemim asfaltim i bllokut të banimit pas Hotel Butrintit”, me procedurë “Kërkesë me propozim, me dëm ekonomik në vlerën **240,890 lekë**,

-“Pastrimi i qytetit të Bashkisë Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **1,956,640 lekë**,

-“Sistemim e asfaltim segmente rrugore në zonën e sipërme të qytetit (L.Dardhës mbi Spital), Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, **254,760 lekë**,

-“Ndërtim,asfaltim rruga H.Freskia-Xhamia-Manastiri i 40 Shenjtorëve”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **376,112 lekë**,

-“Punime në ambientet e brendshme në stadiumin e futbollit, Sarandë (vazhdim)”, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me dëm ekonomik në vlerën **563,312 lekë**,

-“Rikonstruksion KUB, KUZ i Rrugës Turizmit-Peshkimi i Vjetër”, me procedurë “Tender i hapur”, me dëm ekonomik në vlerën **984,222 lekë**,

A.2

-për 9 tendera, të cilët duhej të ishin anuluar dhe përsëritur nga e para, sepse nuk kanë elementin e dytë të konkurrimit (operatorin konkurrues) ose nuk kanë plotësuar që të gjithë operatorët konkurrues 100% kërkesat për kualifikim, me vlerë totale fondi limit me tvsh-në prej 121,060 mijë lekë ose në vlerë totale të kontratave të lidhura me tvsh-në prej 103,365 mijë lekë, në këto tendera dhe me anëtarët përkatës të KVO-së:

-“Ndërtim i Rrugës nr. 1, Gjashtë, Loti II”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh-në 15,245,004 lekë, fituar sipas kontratës së lidhur me vlerë 11,145,989 lekë,

-“Rikonstruksion i Stadiumit të Futbollit, Sarandë”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh 10 milion lekë, vlera e kontratës me tvsh-në 7,809,138 lekë,

-“Sistemim asfaltim i bllokut të banimit pas Hotel Butrintit”, me procedurë “Kërkesë me propozim, fondi limit me tvsh 5,475,000 lekë, vlera e kontratës me tvsh 4,271,239 lekë,

-“Pastrimi i qytetit të Bashkisë Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh 26,357,860 lekë, vlera e kontratës 26,177,673 lekë,

-“Sistemim e asfaltim segmente rrugore në zonën e sipërme të qytetit (L. Dardhës mbi Spital), Sarandë”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh 5,187,000 lekë, vlera e kontratës me tvsh 3,820,740 lekë,

-“Asfalti i Rrugës Vilës”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh 42,120,310 lekë, vlera e kontratës me tvsh 34,285,473 lekë,

-“Ndërtim-asfaltim Rruga H.Freskia-Xhamia-Manastiri i 40 Shenjtorëve”, me procedurë “Tender i hapur”, fondi limit me tvsh 4,950,000 lekë, Vlera e kontratës me tvsh 4,252,122 lekë,

-“Sistemime publike blloku nr. 1, lagja nr. 2 Sarandë”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh 5,625,000 lekë, vlera e kontratës me tvsh 5,560,500 lekë,
-“Rikonstrukcion i stadiumit dhe fushës së futbollit”, me procedurë “Kërkesë me propozim”, fondi limit me tvsh 6,100,000 lekë, vlera e kontratës me tvsh-në 6,041,568 lekë,

II. z. ████████ ish- Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe njëkohësisht sekretari i KRT-së

1. Janë shitur nga drejtuesit e Bashkisë Sarandë, e cila nuk ka titull ligjor si pronare e trojeve të shitura, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 *“Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”* neni 38, dhe ne kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 29.07.1995, *“Për shitblerjen e trojeve”* neni 3.

-gjatë viteve 2006-2011 janë kryer shitje trojesh nga Bashkia Sarandë, në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak të marrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe janë kryer veprime të kundraligjshme duke trajtuar dokumentet si: aktvlerësime për çmimin e trojeve, të nënshkruar nga drejtori i financës dhe Drejtori i Urbanistikës, për 483 persona në shumën e përgjithshme prej 87,970,832 lekë, vlerë kjo e cila nuk është kaluar në llogarinë e krijimit të fondit për kompensime për ish pronarë, por është përdorur në mënyrë të kundraligjshme për nevoja të shpenzimeve të bashkisë.

-sipas auditimit me zgjedhje u llogaritën diferencat e çmimit, ku vetëm për 17 raste të vitit 2011, rezulton një diferencë e përgjithshme si dëm ekonomik në vlerën 117,878,000 lekë, e cila është në kundërshtim me VKM 1620, datë 26.11.2008 me çmimin faktik të pagesës, të cilat duhej të arkëtoheshin nga Bashkia Sarandë dhe të kanalizoheshin në llogaritë përkatëse që përdoren për kompensimin e ish pronarëve. (lista nr. 3 bashkëlidhur)

2. Për pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 9 subjekteve për 13 raste është krijuar një dëm ekonomik në vlerën prej 55,437,991.4 lekë. (sipas listës nr. 2 bashkëlidhur) është vepruar në kundërshtim me; nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar *“Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”*, dhe ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 *“Për urbanistikën”* neni 22/1 *“Njësia e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, në bashkitë e kategorisë I, bashkitë e tjera dhe komuna ka këto kompetenca: pika 9 e tij ku përcaktohet: “Përgatit vendimet e KRRT-së dhe dokumentacionin e nevojshëm teknik, bashkë me kushtet urbanistike, sipas studimeve të miratuara. Pas miratimit nga kryetari i KRRT-së, ia dorëzon kërkuesit jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së vendimit, pasi kërkuesi të ketë paguar sipas ligjit detyrimet ndaj shtetit”.*

3. Për periudhën objekt auditimi 2006-2011 nga KRRT e Bashkisë Sarandë, brenda vijës kufizuese të qendrës së qytetit janë dhënë 129 leje ndërtimi, (sipas listës bashkëlidhur me Aneksat e Raportit Përfundimtar të Auditimit), veprime këto në kundërshtim me vendimin e KRRT-ve nr. 3, datë 21.08.2002 *“Për dhënien e lejeve të ndërtimit në qendrat e qyteteve”*, pika 2, që citon: *“Sheshet dhe lejet e ndërtimit, për objektet që propozohen brenda zonës së qendrave të qyteteve për Bashkinë e Tiranës dhe bashkitë e kategorisë së parë (sipas nenit 15 të ligjit nr. 8405, datë 17,09,1998 “Për Urbanistikën”)*, të shqyrtohen vetëm pas miratimit përfundimtar në KRRT-ve të studimeve të reja për këto qendra, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi”.

-Në të gjitha rastet e audituara miratimi i SUP-ve(për rastet e audituara), është bërë në mënyrë formale të KRRT-së, e cila mbi bazën e tij ka miratuar sheshet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit në kundërshtim me të VKM nr. 722, datë 19.11.1998, pikat 44, 46, 47, 48/a dhe 48/b, modeli nr. 10, pikat 66, 72, 74, 79, 85, 91 (tabelat 2, 4, 5) pika 120/ a,b,c,e, 122 dhe 126

4. Në periudhën objekt auditimi 2006-2011 është vepruar në kundërshtim të neneve 21, 50 dhe 53 të ligjit nr.8405 datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”* i ndryshuar, VKM nr 722, datë 19.11.1998, në lidhje me zbardhjen e Formularëve nr. 2 e nr. 4 Vendim *“Për miratimin e*

destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicionet urbane të tij” dhe Leje Ndërtimi në përputhje me Vendimet e KRRT-së ,sipas protokollit të mbledhjes. Për vendimet e mëposhtëme në 17 raste ka zbardhje Leje me kate më shumë se Vendimet e KRRT-së të protokolluara në procesverbalet e mbledhjeve të KRRT-së. konkretisht:

Vendim KRRT-së nr. 3/3, datë 07.10.2006 me ½ kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/20, datë 07.10.2006 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/45, datë 07.10.2006 me 1 kat + papafingo tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/52, datë 07.10.2006 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/55, datë 07.10.2006 me 1 kat + papafingo tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/68, datë 07.10.2006 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/69, datë 07.10.2006 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/30, datë 17.11.2006 me 2 kat më tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/33, datë 17.11.2006 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/37, datë 17.11.2006 me 3 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/41, datë 17.11.2006 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/76, datë 17.11.2006 me 1 kat tepër; Vendimi KRRT-së nr. 1 datë 30.01.2009 me 1 kat më tepër; Vendim KRRT-së nr. 2/95, datë 10.06.2009 me 1 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/29, datë 10.06.2009 me papafingo tepër; Vendim KRRT-së nr. 3/40, datë 10.06.2009 me 6 kat tepër; Vendim KRRT-së nr. 2/21, datë 10.06.2009 me 1 kat tepër.

5. Nga 68 dosje të audituara për periudhën 2006-2011, në 38 raste ka shkelje të studimeve urbanistikë të miratuar me KRRTSH, dhe me Studimet Urbanistike në fuqi edhe legjislacionin në fuqi, ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, dhe me VKM 722, datë 19.11.1998 (viti 2006 për 12 raste, viti 2008 për 12 raste, viti 2009 për 5 raste, viti 2010-2011 për 8 raste).

Më konkretisht shkeljet e konstatuara:

- Në të gjitha rastet e audituara në planimetrinë e sheshit të ndërtimit nuk janë përcaktuar qartë të gjitha rrjetet inxhinierike që furnizojnë objektin që do të ndërtohet (kanalizim, ujësjellës, elektrik, telefoni, mkz, etj.) dhe miratimin e tyre nga ndërmarrjet përkatëse, veprime këto në kundërshtim me pikën 53 të VKM nr. 722.

- Në 7 raste Sheshi i ndërtimit është miratuar në Zonë parashikohet Zonë Plazhi dhe turizmi ditor, Zonë e Gjellbër dhe brenda vijës kufizuese të zonës së qendrës, në kundërshtim me Vendimin e KRRTSH-së 3, datë 19.02.2003 dhe në studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Sarandës miratuar me Vendimin e KRRTSH nr. 1, datë 11.09.2004. (sipas listës bashkëlidhur).

- Në 7 raste Sheshi i ndërtimit është miratuar në Zonë Arkeologjike dhe brenda vijës kufizuese të zonës së qendrës, veprim në kundërshtim me nenin 73 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, me Vendimin e KRRTSH-së 3, datë 19.02.2003 dhe në studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Sarandës miratuar si dhe me Vendimin e KRRTSH nr. 1, datë 11.09.2004. (sipas listës bashkëlidhur).

- Në 7 raste, Sheshi i ndërtimit është miratuar në Zonë qendre dhe Zonë ruajtje dhe rikonstruksion, veprim në kundërshtim me vendimi i KRRTSH nr. 3, datë 21.08.2002 “Për dhënien e lejeve të ndërtimit në qendrat e qyteteve”, pika 2. (sipas listës nr. 1 bashkëlidhur)

- Në 32 raste Sheshi i ndërtimit dhe leje e ndërtimit është miratuar me lartësi në kate me lart se përcaktimi në studimet urbanistike të miratuara si; Vendimi KRRT nr. 45 datë 18.03.1992 studimin urbanistik “Pjesa e sipërme e qytetit”, studimin urbanistik të zonës “Hotel Turizmi-Kanali i Cukës” miratuar me Vendim të KRRTSH-së nr. 3, datë 19.02.1999, si dhe me Vendimin e KRRTSH nr. 1, datë 11.09.2004. Me shkelje të kondicioneve urbane për 71 kate ose 30,457 m² ndërtim. (sipas listës bashkëlidhur)

- Në 12 raste, për 6,714 m² mbi të cilën ka studim pjesor edhe është dhënë leje ndërtimi, nuk ka dokument pronësie, apo kontratë me pronarin e truallit. Veprim në kundërshtim me nenet 40 e 45 të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar. Për sa më lart dokumentacioni i pronësisë administruar në dosje nuk është në përputhje legjislacionin në fuqi

si: nenin 193 të Kodit Civil, nenet 11, 23 dhe 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” me ndryshime, (me nenet 25, 38 dhe 45 të Ligjit Nr. 33/2012, “Për Regjistrimin E Pasurive të Paluajtshme”), pasi në kundërshtim me nenet 40 e 45 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, i ndryshuar është marrë Vendim i KRRT-së pa dokumentacion prone. (sipas listës bashkëlidhur)

-Në të gjitha rastet e audituara nuk ishin të plotësuar të gjitha rubrikat formularëve pjesë integrale e ligjit dhe veçanërisht rubrika mendimi i zyrës së urbanistikës për leje sheshi të ndërtimit dhe leje të ndërtimit, konkretisht formularët nr. 1, nr. 3 dhe nr. 3/1, veprime në kundërshtim nenin 85 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, dhe me VKM 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, pika 53.

- Në të gjitha rastet e audituara nuk janë respektuar kondicionet urbanistike si distancat e volumit të objektit nga kufiri i pronës, distanca nga objektet ekzistuese, distanca nga aksi i rrugës dhe distanca nga bordura e rrugës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 dhe VKM nr. 722, date 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, i ndryshuar, pika 66 dhe pika 120.

- Në të gjitha rastet e audituara nuk janë parashikuar vendeve parkimi ose numri i tyre është më i vogël se numri i apartamenteve sipas projekteve arkitektonikë të shqyrtuara e të miratuara në KRRT, veprime në kundërshtim me VKM nr. 722, date 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, i ndryshuar, pika 85.

- Në të gjitha rastet e audituara nuk ishte respektuar intensiteti i ndërtimit neto konstatuara në projektet arkitektonike të miratuara, veprime në kundërshtim me VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” i ndryshuar, pika 91.

- Në të gjitha rastet e audituara, në dosjet përkatëse të lejeve të ndërtimit nuk kishte një listë të dokumentacionit të ndodhur në të, të pa inventarizuar, pa vendosur numrin në çdo fletë dhe të pa arkivuara, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregullores së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave

- Në 1 rast, kemi transferimin e lejes së ndërtimit për subjekt tjetër ndërtues, veprim në kundërshtim me nenin 47 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, i ndryshuar, ku përcaktohet – “Ndalohej kalimi ose transferimi në çdo formë i lejes së ndërtimit.” Vendim KRRT-së nr. 4/20, datë 17.12.2008,

- Në asnjë rast Procesverbalet e mbledhjeve të KRRT nuk pasqyrojnë deklaratë të anëtarëve të KRRT-së për tu mos u përfshirë në votimin, në ato raste që trajtohen projektet e tyre. Për pasojë nuk mund të gjykohej sa peshë ka patur vota e anëtarëve të KRRT me konfliktet e mundshme të interesit në vendimmarrjen e KRRT (për ata anëtarë KRRT që hartojnë projekte).

III. z. [REDAKTUAR] ish jurist i Drejtorisë së Urbanistikës dhe z. [REDAKTUAR], ish jurist i Drejtorisë së Urbanistikës.

- Në 12 raste, për 6,714 m² mbi të cilën ka studim pjesor edhe është dhënë leje ndërtimi, nuk ka dokument pronësie, apo kontratë me pronarin e truallit. Veprim në kundërshtim me nenet 40 e 45 të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar. Për sa më lart dokumentacioni i pronësisë administruar në dosje nuk është në përputhje legjislacionin në fuqi si: nenin 193 të Kodit Civil, nenet 11, 23 dhe 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” me ndryshime, (me nenet 25, 38 dhe 45 të Ligjit Nr. 33/2012, “Për Regjistrimin E Pasurive të Paluajtshme”), pasi në kundërshtim me nenet 40 e 45 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, i ndryshuar është marrë Vendim i KRRT-së pa dokumentacion prone.

IV. z. [REDAKTUAR] me detyrën e ish K/Inspektorit të INUV dhe Anëtar i KRRT-së nga data 13.11.2008 deri në datë 02.11.2010

-Në **2 raste** në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” me ndryshime, Z. [REDAKTUAR] me detyrën e K/Inspektorit të INUV dhe Anëtar i KRRT-së nga data 13.11.2008 deri në datë 02.11.2010 njëkohësisht ka qenë; Drejtues ligjor e teknik i Subjektit “[REDAKTUAR]” licencës nr. 0365/1 regjistruar në regjistrin themeltar datë 07.09.2004. Subjekti “[REDAKTUAR]” i cili sipas: Vendimit të KRRT-së nr. 3/52, datë 10.06.2009 dhe Vendimi i KRRT nr. 1/3 datë 30.01.2009 është pajisur me dy leje ndërtimi.

V. z. [REDAKTUAR], ish Drejtori i Urbanistikës Ligjore

Për faktin se: Janë shitur nga drejtuesit e Bashkisë Sarandë, **e cila nuk ka titull ligjor si pronare e trojeve të shitura**, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 29.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve” neni 3.

-gjatë viteve 2006-2011 janë kryer shitje trojesh nga Bashkia Sarandë, në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak të marrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe janë kryer veprime të kundraligjshme duke trajtuar dokumentet si: aktvlerësime për çmimin e trojeve, të nënshkruar nga drejtori i financës dhe Drejtori i Urbanistikës, **për 483 persona në shumën e përgjithshme prej 87,970,832 lekë, vlerë kjo e cila nuk është kaluar në llogarinë e krijimit të fondit për kompensime për ish pronarë, por është përdorur në mënyrë të kundraligjshme për nevoja të shpenzimeve të bashkisë.**

-sipas auditimit me zgjedhje u llogaritën diferencat e çmimit, ku vetëm për 17 raste të vitit 2011, rezulton një diferencë e përgjithshme si dëm ekonomik **në vlerën 117,878,000 lekë**, e cila është në kundërshtim me VKM 1620, datë 26.11.2008 me çmimin faktik të pagesës, të cilat duhej të arkëtoheshin nga Bashkia Sarandë dhe të kanalizoheshin në llogaritë përkatëse që përdoren për kompensimin e ish pronarëve.

VI. Z. [REDAKTUAR], me detyrën e ish Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike

Në 14 raste janë nënshkruar kontrata shitblerje trulli me çmime 450-800 lek/m², në shumën e përgjithshme prej 2,812,656 lekë në emër të Bashkisë Sarandë, e cila nuk ka titull ligjor si pronare e trojeve të shitura, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 29.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, neni 3.

E.1 Për z. [REDAKTUAR], i cili ngarkohet me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara gjatë auditimit dhe të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuara nga nenin 248 të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal”, mendojmë që kallëzimi penal të kryhet pasi të bëhet ballafaqimi me personin përgjegjës.

F. PROPOZIM PËR SHQYRTIMIN E PROCEDURËS SË VENDIMIT TË GJYKATËS SARANDË NGA KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË.

1. Kërkojmë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë; në zbatim të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” neni 16 për shqyrtimin e

procedurës së **Vendimit të Gjykatës Sarandë nr. 23-2012-150 (76), date 23.01.2012** “Për njohjen e pronësisë mbi truallin me sipërfaqe prej 1000 m² të ndodhur në lagjen nr. 4 Sarandë, në funksion të objektit të miratuar me vendim KB nr. 5, date 25.06.1999 me kufizime e sipërfaqet e përcaktuara nga eksperti”.

Pasi, nga auditimi janë konstatuar shkelje të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, i ndryshuar, me Rregulloren e Urbanistikës të miratuar me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, të nenit 193 të Kodit Civil, nenet 11, 23 dhe 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” me ndryshime, (me nenet 25, 38 dhe 45 të Ligjit Nr. 33/2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”), si më poshtë:

1. Trualli është shitur nga Bashkia pa e patur në zotërim si prone në kundërshtim me :-nenin 193 të Kodit Civil, nenet 11, 23 dhe 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” me ndryshime, (me nenet 25, 38 dhe 45 të Ligjit Nr. 33/2012, “Për Regjistrimin E Pasurive të Paluajtshme”),

2. Leja e ndërtimit sipas Vendimit të KRRT-së nr. 06, datë 09.04.2000, me objekt: “Klinikë + Banesë” Investitor “██████████” dhe Ndërtues Shoqëria “██████████” sh.p.k. është dhënë për 200 m² sipas VKB nr. 5 datë 25.06.1999 dhe një shtesë për 80 m² sipas Vendimit nr. 52, datë 20.12.1999

3. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe INUV sipas Njoftimit mbi “Identifikimi i sipërfaqeve të përfituara nga hedhja e pa kontrolluara e inerteve ndërtimore dhe që shfrytëzohen nga bizneset private” Sarandë më 24.01.2012, janë përcaktuar sipërfaqet e përfituara nga subjektet private, ku subjekti ██████████ është përcaktuar se përfiton nga hedhja e inerteve në det një sipërfaqeje prej 900 m² plazh.

4. Për njohjen e pronësisë mbi këtë sipërfaqe ka Vendimi të Gjykatës Sarandë nr. 23-2012-150(76), date 23.01.2012 “Për njohjen e pronësisë së paditësit ██████████ mbi truallin me sipërfaqe prej 1000 m² të ndodhur në lagjen nr. 4 Sarandë, në funksion të objektit të miratuar me vendim KB nr. 5, date 25.06.1999 me kufizime e sipërfaqet e përcaktuara nga eksperti depozituar në dosje”. Vendim i shoqëruar edhe me Vendim “Urdhër ekzekutimi” datë 20.08.2012 nga po kjo Gjykatë.

5. Vendimit të INUV Sarandë me nr. 02, date 16.07.2012. dalë në bazë të Procesverbalit nr. 28, datë 16.07.2012 të INUV Sarandë “Për kryerje punimesh pa dokumentacion të plotë Tekniko-Ligjor” përcakton se objekti është në ndërtim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Artan Mirashi, Ymer Stafa, Pal Daçi, Aleksandër Papadhimitri, Alush Zaçe, Xhemal Luka dhe Genc Koka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT